

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pa telefona, pa vonesa, pa berber në hotel! Klopp me “dorë të hekurt” te Gjermania – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/pa-telefona-pa-vonesa-pa-berber-ne-hotel-klopp-me-dore-te-hekurrt-te-gjermania/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:58:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 09:23:54 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d229332b15a36bfc154329076632a81a24c6c93dc5636d933dc10b21d1bf137a
TEKSTI	8d1a8e1466d92bdb59f54612e8f1a263bee6a95e81cd3356b90f0c1f4223daba
PAMJA	d682120bfa016e1d9219cac10ea4976e4a67aef28aa86f2dcd099472fdafd5dd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4afcb83ad19c46400db59284ed7c4ef966473876c721738b7da216a950b233c6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4afcb83ad19c46400db59284ed7c4ef966473876c721738b7da216a950b233c6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Sipas raportimeve të DIEL, Klopp ka vendosur disa rregulla të reja që ndryshojnë nga mënyra e funksionimit gjatë epokës së Julian Nagelsmann.

Një prej tyre lidhet me darkat e ekipit. Futbollistët duhet të paraqiten në kohë dhe së bashku në orarin e përcaktuar, në mënyrë që vakti të shërbejë edhe si një moment për komunikim dhe forcimin e frymës së grupit. Më parë, lojtarët kishin më shumë fleksibilitet për të mbërritur në intervalin e përcaktuar.

Një tjetër rregull ka të bëjë me telefonat celularë. Sipas raportimeve, përdorimi i tyre nuk lejohet gjatë përgatitjeve para ndeshjeve, përfshirë aktivizimin fizik në palestër, trajtimet dhe masazhet.

REKLAMË

Ideja është që lojtarët të jenë të përqendruar te ndeshja dhe të komunikojnë më shumë me njëri-tjetrin.

Edhe prerjet e flokëve në hotelin e kombëtares janë ndaluar. Lojtarët pritet të kujdesen për këtë aspekt përpara grumbullimit, duke shmangur ndërhyrjet personale gjatë qëndrimit me ekipin.

Ndërkohë, Klopp raportohet se ka vendosur të kufizojë vizitat e familjarëve gjatë turneve të mëdha. Në vend që familjet të qëndrojnë rregullisht pranë skuadrës, vizitat do të lejohen vetëm në raste të caktuara. Synimi i raportuar është që futbollistët të fokusohen te objektivi i përbashkët dhe të krijojnë një lidhje më të fortë si grup.

Këto masa vijnë në fillim të epokës së Kloppit në stolin e Giermanisë.

5 Ndryshime në drejtimin e Policisë së Shtetit, emërime të reja në disa qarqe

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

REKLAMË

Trajneri 59-vjeçar ka grumbulluar 44 lojtarë në dy skuadra për katër ndeshjet e para të Nations League, një tjetër vendim i pazakontë për të menaxhuar ngarkesën dhe për të vëzhguar sa më shumë futbollistë.

Klopp kërkon të ndërtojë një Gjermani me rregulla të qarta, komunikim më të madh dhe përqendrim maksimal, ndërsa puna e tij me "Mannschaft"-in sapo ka nisur.

#Gjermania

#Klopp



WRITTEN BY
Adnand Kolgjokaj

Gazetar/e · Vizion Plus

Të gjithë artikujt →

Vazhdo të lexosh



SPORT

Deri në moshën 41 vjeçare me Francën?...

Adnand Kolgjokaj 23 Sht 16:01



SPORT

Di Maria për Messin: Do të jetë shumë e...

Adnand Kolgjokaj 23 Sht 14:09



SPORT

Nga golat te veprat e mëdha! Sadio Mane...

Adnand Kolgjokaj 23 Sht 12:37

REKLAMË

Lini një koment

Komenti juaj *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

Emri *

E-mail *

Nuk publikohet kurrë.

☐ Ruaje emrin dhe e-mailin tim në këtë shfletues për herën tjetër që komentoj.

Posto komentin



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

LIVE



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.